



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BANKA E SHQIPËRISË

Nr. 4060 prot.
Tiranë, më 16.09.2025



INSTITUTI I STATISTIKAVE

Nr. 1606 prot.
Tiranë, më 09.09.2025

MEMORANDUM MIRËKUPtimi

midis

BANKËS SË SHQIPËRISË
Në vijim referuar si "BSH" dhe

dhe

INSTITUTIT TË STATISTIKAVE
në vijim referuar si "INSTAT"

TIRANË _____



Preambula

- Bazuar në nenin 26 të Ligjit nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare”, ku përcaktohet mënyra e bashkëpunimit dhe shkëmbimi i informacionit ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe INSTAT;
- Duke pasur parasysh përmbushjen e detyrave statistikore nga Instituti i Statistikave të Shqipërisë (INSTAT), në përputhje me Ligjin Nr. 17/2018 "Për statistikat zyrtare" dhe detyrimet e tij brenda Sistemit Statistikor Evropian (ESS) në zbatim të Rregullores (KE) Nr. 223/2009 mbi statistikat evropiane;
- Duke pasur parasysh përmbushjen e detyrave statistikore nga Banka e Shqipërisë, në përputhje me Ligjin për Bankën e Shqipërisë dhe detyrimet e saj brenda Sistemit Evropian të Bankave Qendrore (SEBQ) dhe Sistemit Statistikor Evropian (ESS) dhe Rregullores (KE) Nr. 2533/98 mbi mbledhjen e informacionit statistikor nga Banka Qendrore Evropiane;
- Duke theksuar përgjegjësinë e përbashkët dhe detyrimet përkatëse të Institutit të Statistikave dhe Bankës së Shqipërisë në disa fusha statistikore;
- Duke njohur interesin e madh të Bankës së Shqipërisë si përdoruese e statistikave mbi ekonominë reale dhe çmimet për qëllimet e politikës monetare dhe stabilitetit financiar;
- Duke pasur parasysh nevojën dhe praktikën e bashkëpunimit të ngushtë në nivel evropian me Sistemin Statistikor Evropian (ESS) dhe Sistemin Evropian të Bankave Qendrore (SEBQ), në përputhje me nenin 2a të Rregullores (KE) Nr. 2533/98 mbi mbledhjen e informacionit statistikor nga Banka Qendrore Evropiane dhe nenin 9 të Rregullores (KE) Nr. 223/2009 mbi statistikat evropiane, për të garantuar rezultate statistikore të cilësisë së lartë, për të minimizuar barrën raportuese dhe për të siguruar koherencën e nevojshme për prodhimin e statistikave evropiane, dhe duke marrë parasysh mirëkuptimin e ndërsjellë që këto objektiva janë gjithashtu karakteristika të bashkëpunimit midis INSTAT dhe Bankës së Shqipërisë;
- Me synimin e përbashkët për të zhvilluar më tej marrëdhëniet e bashkëpunimit të gjata dhe të besueshme që kanë ekzistuar midis INSTAT dhe Bankës së Shqipërisë, në përmbushjen e detyrave në nivel kombëtar dhe të detyrimeve në një kontekst ndërkombëtar, veçanërisht në nivel evropian;
- Duke pasur mirëkuptim të ndërsjellë për kornizën ligjore, organizative, të burimeve njerëzore dhe financiare, në të cilën operon secila palë, dhe me dëshirën për të përfituar nga sinergjitë ekzistuese dhe për të zhvilluar, prodhuar dhe shpërndarë të dhëna statistikore të cilësisë së lartë;
- Duke marrë parasysh parimet themelore të Kombeve të Bashkuara mbi statistikat zyrtare, rekomandimet ndërkombëtare dhe evropiane për cilësinë e statistikave zyrtare, praktikat më



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

të mira dhe, në rastin e INSTAT-it, nenet 4 e 5 të ligjit për statistikat zyrtare të cilat përafrojnë Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane, dhe në rastin e Bankës së Shqipërisë, Kodin e Praktikave për Statistikat në BSH sipas Angazhimit Publik për Statistikat Evropiane nga SEBQ;

INSTAT dhe BSH (këtej e në vijim “Palët”) shprehin gatishmërinë për të vijuar bashkëpunimin mbi bazën e angazhimeve të përcaktuara në këtë memorandum dhe, në dritën e sfidave të shumta me të cilat përballen statistikat zyrtare, për të avancuar këtë bashkëpunim në një mënyrë efektive dhe të orientuar drejt së ardhmes.

Neni 1

Objekti

1. Ky Memorandum Mirëkuptimi ka për objekt shprehjen e vullnetit për bashkëpunim në drejtim të përmirësimit të statistikave zyrtare në vend, përcaktimin e fushave të bashkëpunimit ndërmjet palëve nënshkruese, përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësive në interes të zbatimit të parimeve statistikore dhe mbrojtjes së konfidencialitetit statistikor.
2. Palët e këtij Memorandumi, duke vepruar mbi bazën e dispozitave të tij, si dhe akteve ligjore e nënligjore në fuqi, angazhohen të përforcojnë, promovojnë dhe zhvillojnë bashkëpunimin e tyre reciprok, duke respektuar statusin juridik që gëzon secila palë si institucion i pavarur drejt përfitimit të përbashkët në çdo fushë të parashikuar në këtë Memorandum.

Neni 2

Fushëveprimi i bashkëpunimit

1. Fushat e bashkëpunimit zhvilluar në frymën e partneritetit dhe me një ndarje të punës sipas fushës së përgjegjësisë ligjore të secilës palë përfshijnë:
 - a) angazhimin e përbashkët në çështjet statistikore horizontale që kanë të bëjnë me:
 - përcaktimin e objektivave strategjikë zhvillimorë në fushën e statistikave makro-ekonomike;
 - analizën e serive kohore, përfshirë axhustimet sezonale, metodologjitë dhe praktikat e detajimeve të përkohshme;
 - politikat e revizionimit;
 - praktikat dhe metodologjitë e cilësisë së të dhënave;



- zgjidhjet teknike të përbashkëta;
 - koordinimin dhe përmirësimin e shkëmbimit të të dhënave;
 - reduktimin e ngarkesës së furnizuesve me të dhëna;
- b) llogaritë kombëtare dhe llogaritë financiare;
- c) statistikat për sektorin qeveritar të lidhura me procedurën e deficitit të tepruar (EDP);
- d) statistikat e tregtisë së jashtme;
- e) statistikat e bilancit të pagesave;
- f) harmonizimin e të ardhurave kombëtare bruto;
- g) statistikat e korporatave si statistikat e filialeve të huaja (FATS);
- h) sigurimin e cilësisë statistikore në trajtimin e grupeve të ndërmarrjeve shumëkombëshe;
- i) përmirësimin e regjistrit për të dhënat bazë të ndërmarrjeve;
- j) statistikat që lidhen me ndryshimet klimaterike;
- k) shkëmbimin e të dhënave kryesore në përputhje me bazën rregullatore dhe shkëmbimi i informacionit në lidhje me klasifikimin e subjekteve ekonomike në sektorë institucionalë në përputhje me Sistemin e Llogarive Kombëtare;
- l) angazhimin në fushën e rregullimit sezonal, si dhe statistikat e përdorura në procedurën e çekuilibrit makroekonomik (MIP).
2. Fusha e bashkëpunimit gjithashtu përfshin kryerjen e detyrave të përbashkëta në kontekste ndërkombëtare, të tilla si Kombet e Bashkuara, Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), Eurostat dhe Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), veçanërisht në drejtim të përmbushjes së standardeve ndërkombëtare, si Standardi i Special i Shpërndarjes së të Dhënave të FMN-së (SDDS) dhe, në nivelin evropian, në Forumin Statistikor Evropian (ESF), në Komitetin për Statistika Monetare, Financiare dhe të Bilancit të Pagesave (CMFB) dhe për përmbushjen e kërkesave si pjesë e rekomandimeve të Bordit Evropian për Rrezikun Sistemik (ESRB). Ky bashkëpunim përfshin gjithashtu shkëmbimin e informacionit dhe konsultimin, nëse është e përshtatshme dhe e lejueshme, në kuadër të punës së Komitetit të Statistikave të sistemit të Bankave Qendrore (STC) të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe Komitetit të Sistemit Statistikor Evropian (ESSC).
3. Bashkëpunimi përfshin gjithashtu zhvillimin e metodave, procedurave dhe teknikave statistikore, të dakordësuara dhe të pajtueshme reciprokisht, me kusht që kjo të jetë e nevojshme që secila palë të përmbushë detyrat e saj nën përgjegjësi si dhe duke respektuar fushat e përgjegjësiave ligjore të secilës palë.



4. Për të siguruar zbatimin e angazhimeve të marra nëpërmjet këtij Memorandumi si dhe në përmbushje të detyrimeve ligjore mbi prodhimin e statistikave zyrtare, palët ngrejnë grupe pune të përbashkët me përbërje të barabartë përfaqësuesish dhe me detyra reciproke të mirëpërcaktuara.

Neni 3

Shkëmbimi i informacionit

1. Palët dakordësohen t'i japin njëra-tjetrës të dhënat statistikore dhe informacion shoqërues të kërkuar për kryerjen e detyrave në fushat e bashkëpunimit sipas nenit 2 të këtij Memorandumi, duke respektuar bazën ligjore dhe afatet kohore të dakordësuara ndërmjet palëve.
2. Palët marrin përsipër të shkëmbejnë ose transmetojnë informacion në mënyrë gjithëpërfshirës dhe në kohë, në përputhje me bazën ligjore, për fushat statistikore në të cilat bashkëpunimi konsiderohet i rëndësishëm sipas kësaj marrëveshjeje.
3. Palët sigurojnë që informacionet statistikore që ata ofrojnë në faqet elektronike zyrtare të përmbajnë lidhje elektronike me fushat statistikore të ndërlidhura të palës tjetër.
4. Informacioni do të ndahet në mënyrë të vazhdueshme në nivel teknik, përmes grupeve të punës dhe ekipeve të përbashkëta të ngritura me urdhër të veçantë sipas pikës 4 të nenit 2 të këtij Memorandumi.
5. Në kryerjen e detyrave të tyre të përbashkëta në një kontekst ndërkombëtar dhe në nivel evropian, palët veçanërisht marrin përsipër të përcjellin dokumente dhe të konsultohen me njëra-tjetrën për aq sa kjo është e mundur sipas rregullimit ligjor.
6. Palët dakordësohen për marrjen e masave paraprake në infrastrukturën teknologjike dhe kuadrin rregullator për të siguruar konfidencialitetin e të dhënave të transmetuara në mënyrë të sigurt nga secila palë sipas legjislacionit për statistikat zyrtare dhe atij për mbrojtjen e të dhënave personale.
7. Në çdo rast, bashkëpunimi i ndërsjellë gjatë të këtij Memorandumi do të udhëhiqet nga parimet e etikës profesionale dhe shmangies së konfliktit të interesit sipas legjislacionit në fuqi

Neni 4

Komunikimi ndërmjet palëve

1. Komunikimi ndërmjet palëve do të zhvillohet në formë shkresore duke përdorur referencat ligjore reciproke dhe dispozitat e këtij Memorandumi.
2. Instituti i Statistikave dhe Banka e Shqipërisë, nëpërmjet Departamentit të Statistikave Financiare, dakordësohen të organizojnë takime të rregullta vjetore në nivel drejtues për të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

diskutuar mbi çështje që lidhen me punën e tyre të përbashkët statistikore dhe çështjet aktuale me rëndësi strategjike për zhvillim statistikor.

Neni 5

Të drejtat e përdoruesve

1. Palët dakordësohen që shkëmbimi i informacionit dhe i opinioneve ndaj përdoruesve të statistikave zyrtare do të kryhet duke marrë në konsideratë interesin e fortë të Bankës së Shqipërisë si përdorues i statistikave zyrtare mbi ekonominë reale dhe çmimet, për qëllime të politikës monetare dhe analizës së stabilitetit financiar.
2. Përgjegjësia statistikore e INSTAT mbetet e paprekur.

Neni 6

Mbrojtja e të dhënave dhe konfidencialiteti

Palët angazhohen të respektojnë rreptësisht të gjitha dispozitat për mbrojtjen e të dhënave dhe konfidencialitetin statistikor sipas legjislacionit në fuqi, duke ndërmarrë masa paraprake për mbrojtjen e tyre dhe veprimet e nevojshme në rast të shkeljeve.

Neni 7

Përgjegjësia

1. Ky Memorandum nuk sjell detyrime financiare, përveç rasteve kur Palët dakordësohen ndryshe nëpërmjet marrëveshjeve të veçanta.
2. Ky Memorandum nuk përbën një detyrim ligjor, përveç kërkesave të pikës 3 të nenit 26 të Ligjit nr. 17/2018 “Për statistikën zyrtare” dhe nuk sjell asnjë përgjegjësi për shkak të shkeljeve të tij.

Neni 8

Rishikimi dhe përditësimi

1. Ky memorandum do të rishikohet periodikisht dhe mund të përditësohet sipas nevojës, në bazë të rregullave dhe kërkesave të reja kombëtare apo ndërkombëtare, si dhe duke u bazuar në zhvillimet e reja në fushën e statistikave zyrtare.
2. Çdo shtesë apo ndryshim i këtij Memorandumi kryhet dhe hyn në fuqi vetëm pas nënshkrimit nga të dyja palët.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Neni 9

Hyrja në fuqi dhe afati

Ky Memorandum hyn në fuqi nga data e nënshkrimit nga palët dhe mbetet në fuqi për një periudhë të pacaktuar.

Neni 10

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin apo zbatimin e këtij Memorandumi, do të zgjidhet me mirëkuptim dhe bashkëpunim mes palëve
2. Çdo palë mund të ndërpresë këtë marrëveshje me një njoftim jo më vonë se 60 ditë përpara, me përpjekje për të arritur një marrëveshje të re para skadimit të afatit.

Neni 11

Dispozita të Fundit

1. Mbështetur në këtë Memorandum Mirëkuptimi, palët mund të hartojnë marrëveshje të tjera që përcaktojnë në detaje fushat e bashkëpunimit.
2. Memorandumi i Mirëkuptimit nr. 3672 prot., datë 12.05.08 nënshkruar ndërmjet INSTAT dhe BSH, shfuqizohet.
3. Memorandumi hartohet në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe, me vlerë të njëjtë.

PËR

BANKËN E SHQIPËRISË

GENT SEJKO

GUVERNATOR



PËR

INSTITUTIN E STATISTIKAVE

ELSA DHULI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

